



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

Më
Dana

24-04-2018

P.nr.1133/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi si dhe procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] K. Shtime, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1119-5/2015 të dt. 29.11.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Albert Zenjullahu, të dëmtuarit [REDACTED] si dhe të pandehurit [REDACTED], me datë 14.03.2018 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 19.03.2018 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: [REDACTED] i lindur me dt [REDACTED], nga i ati [REDACTED], nëna [REDACTED], e gjinisë [REDACTED], me vendbanim në Fsh. [REDACTED] K. Shtime, student, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 11.05.2015, rreth orës 19:30, në rrugën lokale të Fsh. Pjetershticë në drejtim të rrugës rajonale Komoran – Carralevë, përkatësisht me të arritur në kryqëzimin e këtyre rrugëve, duke drejtuar automjetin e markës VW Golf II, pa targë të regjistrimit, e duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 64.1 të LSKRR-se, në momentin kur i është ofruar kryqëzimit, nuk ka lëvizur me kujdes të shtuar, nuk ka ndal veturën para se të hyj në kryqëzim në shenjë STOP për ta lëshuar veturën Opel Astra me targa të regjistrimit [REDACTED] të cilën e ka drejtuar [REDACTED], duke e goditur me pjesën e përparme të djathtë në anën e majtë anësore, ku nga forca goditëse kjo veturë godet në pjesën e përparme të majtë veturën Opel Kadet me targa të regjistrimit [REDACTED], të cilën e ka drejtuar [REDACTED], të cilat vetura kanë pasur përparësi kalimi në këtë kryqëzim pasi kanë lëvizur rrugës me përparësi kalimi, ku nga pasojat e kësaj goditje përveç dëmeve materiale të shkaktuara në të tri veturat, lëndime të lehta trupore ka pësuar [REDACTED] dhe [REDACTED] ndërsa

tekë [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] nuk janë konstatuar lëndime trupore sipas ekspertizës mjeko-ligjore të datës 29.10.2016 respektivisht datës 27.07.2017.

me të cilën kreu veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të sipër theksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 4,5,8,11,41,43,45,49,50,51,73,74, të KPK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehur in e,

G J Y K O N

- Dënim me burg ne kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej 1 /një/ viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
- Të dëmtuarit [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] K. Shtime, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro (tridhjetë) si dhe shpenzimet e procedurës penale ekspertiza mjeko-ligjore 50 Euro (pesëdhjetë), ekspertiza e komunikacionit 40.88 Euro (katërdhjetë) si dhe plotësimin e ekspertizës mjeko-ligjore 20 Euro (njëzet), në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Arsyetimi

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën të evidentuar PP/II.nr.1119-5/2015 të datës 29.11.2016 ka ngarkuar të pandehurin Besmir Dugolli për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe mbeti në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të i shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze fillimisht caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 09.06.2017, për ç'ka i pandehuri edhe në këtë seancë ka pranuar fajësinë, mirëpo gjyqtari me rastin e marrjes së mendimit mbi pranimin e fajësisë të të pandehurit, nga ana e të dëmtuarit [REDAKTUAR], ky i fundit prezanton rrethana në të cilën pos të dëmtuarve në ekspertizën mjeko-ligjore të dt. 29.10.2016, lëndime trupor ka pësuar edhe pasagjerja [REDAKTUAR] për ç'ka ofron raportet mjekësore, andaj mbi bazë të kësaj gjyqtari me aktvendim procedural i refuzon pranimin e fajësisë të pandehurin dhe urdhëron plotësim të ekspertizës mjeko-ligjore dhe marrjes së ekzaminimit, Gjykata me datë 14.03.2017, ka caktuar shqyrtim gjyqësor ky i akuzuari [REDAKTUAR] është deklaruar: *ndihem fajtor për veprën për të cilën me ngarkon akuza sipas të gjitha pikave të saj, jam i vetëdijshëm për pranimin dhe pasojat e fajësisë që mund të vijn, i kërkojë falje publike të dëmtuarve, është hera e parë që ndeshem me ligjin, i premtoj gjykatës që do të shtoj kujdesin në komunikacion, jam i gjendjes se dobët ekonomike i pa pune, lus gjykatën që gjatë matjes së dënimit të më shqipton një dënim sa më të but.*

Prokurori i shtetit Albert Zenjullahu duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht: ekspertiza e komunikacionit e dt.06.03.2016, ekspertiza mjeko- ligjore e datës 29.10.2016, plotësimi i ekspertizës mjeko- ligjore e dt. 27.07.2017, raporti i aksidentit me nr. 2015-AU-0141 i dt. 11.05.2015 si dhe fotografitë dhe provat të tjera të cilat gjenden ne shkresat e lëndës të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore me përjashtim të plotësimit të ekspertizës;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike;
- Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i pandehuri në rrugën lokale të Fsh. Pjetershticë në drejtim të rrugës rajonale Komoran – Carralevë, përkatësisht me të arritur në kryqëzimin e këtyre rrugëve, duke drejtuar automjetin e markës VW Golf II, pa targë të regjistrimit, e duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 64.1 të LSKRR-se, në momentin kur i është ofruar kryqëzimit, nuk ka lëvizur me kujdes të shtuar, nuk ka ndal veturën para se të hyj në

kryqëzim në shenjën STOP për ta lëshuar veturën Opel Astra me targa te regjistrimit [REDACTED] të cilën e ka drejtuar [REDACTED], duke e goditur me pjesën e përparme të djathtë në anën e majtë anësore, ku nga forca goditëse kjo veturë godet në pjesën e përparme të majtë veturën Opel Kadet me targa te regjistrimit [REDACTED], të cilën e ka drejtuar [REDACTED] te cilat vetura kanë pasur përparësi kalimi në këtë kryqëzim pasi kanë lëvizur rrugës me përparësi kalimi, ku nga pasojat e kësaj goditje përveç dëmeve materiale të shkaktuara në të tri veturat, lëndime të lehta trupore ka pësuar [REDACTED] dhe [REDACTED] ndërsa tekë [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] nuk janë konstatuar lëndime trupore sipas ekspertizës mjeko-ligjore të datës 29.10.2016 respektivisht datës 27.07.2017.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese përkatësisht që në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, nuk ka dëshmi se është gjykuar me vendim të formës së prerë, moshën e re, dhe gjendjen e rëndë ekonomike, ndera në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Të dëmtuarit [REDACTED] [REDACTED] dhe [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] K. Shtime, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 30 Euro (tridhjetë) si dhe shpenzimet e procedurës penale ekspertiza mjeko-ligjore 50 Euro (pesëdhjetë), ekspertiza e komunikacionit 40.88 Euro (katërdhjetë) si dhe plotësimin e ekspertizës mjeko-ligjore 20 Euro (njëzet), në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
Divizioni Penal, P.nr.1133/16, me datë 19.03.2018**

Zyrtare ligjore,
Kadisha Shabani

Gjyqtari Ilir BYTYQI


KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.